



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U**  
**PRISTINU/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN PRISHTINA**

Nr.regj.16939/ 2010

**GJKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**, përmes Gjyqtarës **Salihe Berisha – Ahmetaj** me sekretarin juridik Naim Thaqi, duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit Argjent Ismet Shala nga Prishtina për shkak të kundërvajtjes nga neni 16.1.2, e në lidhje me nenin 7.1 të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publike, në bazë të nenit 37, 195, të Ligjit mbi kundërvajtjet, më datën **05.07.2010**, harton këtë

**A K T V E N D I M**

I pandehuri **Argjent Ismet Shala** i lindur më 22.11.1977 në Mitrovicë, me vendbanim në Prishtinë B.Diellit Lajga Mati I Objekti 3 2/2, Prishtinë, me profesion Jurist punon në Ministrinë e punëve të jashtme në ambasadën e Kosovës në Paris, i pa martuar, me gjendje të mirë ekonomike i pa denuar më parë për kundërvajtje, huk është nën hetime,

**Ë S H T Ë P Ë R G J E G J Ë S E**

Sepse nuk ka deklaruar pasurinë, për vitin 2009 në Agjensionin kundër Korrupsionit në Prishtinë deri me datën 31.03.2010, - me çka i pandehuri ka kryer kundërvajtjen nga neni 16.1.2, e në lidhje me nenin 7.1 të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publike, andaj në bazë të dispozitave të të njejtit Ligj

**D Ë N O H E T**

**ME DËNIM NË TË HOLLA** në shumen prej **200€**, të cilin denim e pandehura është e obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, e nëse pagesen nuk e bën në afatin e cekur, dënimi me të holla ka për t'iu zëvendësuar më denim burgu në kohëzgjatje prej **13** ditësh, duke llogaritur një ditë burgu me **15 €**.

Obligohet e pandehura që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **5 €**, në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij aktvendimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Dënimin dhe paushallin gjyqësor e paguan në këtë gjykatë.

Me nga një kopje të Aktvendimit të njoftohen i pandehuri dhe parashtuesi i kërkesës.

**A r s y e t i m**

**Agjencia kunder Korrupsionit**, me kërkesën nr.01/2275/10, të datës 15.06.2010 ka propozuar që kundër të pandehurit, të zhvillohet procedura kundërvajtëse, të shpallët përgjegjës dhe të ndëshkohet në bazë të Ligjit, për shkak të kundërvajtjes të përshkruar në dispozitiv.

Sipas kërkesës së parashtuar është zhvilluar procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit Argjent I. Shala, i cili mbrojtjen e paraqitur pranë kësaj gjykate i mohon të dhënat nga kërkesa se ka kryer kundërvajtjen që i vihet në barrë sipas kërkesës sepse si zyrtar i lartë i Ministrisë së punëve të jashtme të Rep. së Kosovës gjegjësisht në postin e sekretarit të parë të Ambasadës së Kosovës në Francë është përzgjedhur në fund të nëntorit 2009 ose në janar të vitit 2010 për çka nuk është i sigurt për datën e saktë ndërsa nga shteti i Francës në këtë postë është akredituar më datën 14.04.2010 dhe për këto arsye nuk e ndien vendin përgjegjës për veprën që i vihet në barrë sipas kërkesës.

Pas shtjellimit të provave gjatë procedurës, shiqimit të të dhënave në kërkesë dhe deklarates së të pandehurit gjykatësja ka fituar bindjen e lirë se i pandehuri është përgjegjës për kundërvajtjen e sanksionuar sipas nenit 16.1.2, e në lidhje me nenin 7.1 të Ligjit për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë dhe të dhuratave të zyrtarëve të lartë publike, Sepse nuk ka deklaruar pasurinë, për vitin 2009 në Agjensionin kundër Korrupsionit në Prishtinë deri me datën 31.03.2010. prandaj duke marr parasysh tëra rrethanat lehtësuese dhe rënduese të cilat ndikojnë në shqiptimin e drejtë të dënimit Ligjor, duke pasur parasysh se dënimi i shqiptuar do të ndikoi pozitivisht që në të ardhmen mos të kryej kundërvajtje të tillë apo të ngjajshme, i shqiptoi dënimin me të holla e conform nenit të lartëcekur sepse zyrtari i lartë publik është i obliguar që brenda 60 ditësh nga dita e fillimit të punës apo zgjedhjes në këtë post të bëjë deklarimin e pasurisë së vet dhe të anëtarëve të familjes, andaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Vendimi mbi paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 109 të Ligjit mbi kundërvajtjet.

**GJKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË**

Nr. 16939/ 2010 të datës 05.07.2010

**GJYKATËSJA**  
**Salihe Berisha – Ahmetaj**

**UDHËZIME MBI MJETIN JURIDIK** Kundër këtij aktvendimi të drejtë ankese kanë i pandehuri dhe parashtuesi i kërkesës, Gjykatës së Lartë për kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi përmes kësaj gjykate, pa pulla.

|                                                         |            |
|---------------------------------------------------------|------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO |            |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT                            |            |
| AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE                               |            |
| ANTI-CORRUPTION AGENCY                                  |            |
| Dep.                                                    |            |
| Dep.                                                    |            |
| Dep.                                                    |            |
| Nr. llog.                                               |            |
| Broj stranica                                           |            |
| Nr. pages                                               |            |
| Nr. d. m. t.                                            |            |
| B. m. t.                                                |            |
| Proj. no.                                               | 03/2557/10 |
| Datum                                                   | 08.07.2010 |